



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1108/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada-Gllogjani kryesuese, Milena Đerić dhe Kymete Kicaj anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë-dega në Junik, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Junik, për shkak të vendosjes së posterave në shtyllë elektrike, për raundin e Dytë për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.11.2021, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.1108/2021 e datës 08.11.2021, paraqitur nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë-dega në Junik, kundër Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë- dega në Junik, për shkak vendosjes së posterave në shtyllë elektrike.

A r s y e t i m

PZAP, me datë 08.11.2021 ka pranuar ankesë nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Junik, me të cilën ndër të tjera pretendon se me datë 8 nëntor 2021, rreth orës 13:30, kanë vërejtur se aktivistët e subjekti politik AAK, kanë vendosur material zgjedhor (poster-baner) në shtyllë elektrike, të kandidatit për Kryetar të Komunës Agron Kuqi. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 33 pika b, LZP-së. Andaj duke u mbështetur në të cekurat më lartë kërkojmë nga ana e PZAP, që masa e sanksionit të vendosët në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përdorur si precedent dhe analogji marrë parasysh natyrën e shkeljes dhe ndikimin e saj në procesin zgjedhor.

PZAP, me datë 09.11.2021, i ka dërguar kërkesë për përgjigje Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), duke i kërkuar që të përgjigjet deri me datë 10.11.2021, në ora 10:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 10.11.2021, subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ndër të tjera pretendon se: sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me ankesën, që ka të bëjë me vendosjen e posterave në shtyllën elektrike, këto pretendime janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuar për faktin se vendosja e këtij posterit është bërë nga kompania e cila i ka në shfrytëzim hapësirat publike. Po ashtu, vendi në të cilin është i vendosur posterit edhe më herët ka shërbyer për reklamim nga kompania e cila merret me menaxhimin dhe shfrytëzimin e hapësirave publike në Komunën e Junikut. Kërkon nga ana e PZAP-së që të refuzohet si e pa bazuar ankesa.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë, Paneli konstaton se nga ana e Subjektit Politik AAK-së, nuk është bërë shkelje e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri lëndor i kandidatit për Kryetar të Komunës së Junikut nga radhët e AAK-së, është vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterëve.

Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, dhe shkelje të Kodit të Mirësjelljes nga Subjekti Politik AAK, pasi që posteri në fjalë është vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e tyre, ashtu siç vërtetohet edhe nga fotografia e bashkangjitur në ankesë nga pala ankuese që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1108/2021 më datë 11.11.2021

Kryesuese e Panelit

Afijete Sada-Ghogjani

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.1 të LZP-së.

